



Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Raport i vitit 2021

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	3
Kapitulli I Struktura dhe Buxheti.....	4
Kapitulli II Integrimi Evropian	6
○ II-1. Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi me Projektet	6
○ II-2. Bashkëpunimi me projektin	
II-2/a. Njësitë e Integritimit Evropian.....	6
II-2/b. Organizimi i TAIEX rolin e bashkive në zbatimin e Acquie.....	7
○ II-3. Matrica e Performancës së Bashkive në kuadër të Integritimit Evropian	8
Kapitulli III Praktikrat e Mira.....	9
Kapitulli IV Këshilli Konsultativ.....	14
Aneks 1 Lista e akteve të miratuara në Këshillin Konsultativ.....	20
Aneks 2 Matrica e Kompetencave për vitin 2021.....	24

Fjala hyrëse

Agjencia për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore edhe gjatë vitit 2021 ka vepruar ne mbështetje te punës dhe nevojave NJVV-ve për realizimin në praktikë të reformës së decentralizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të qeverisjes, të pasqyruar në nivelin dhe gamën e shërbimeve publike vendore, rritjes së transparencës, konsolidimin e funksioneve të transferuara drejt nivelit vendor, fuqizimit dhe ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, standartizimin e shërbimeve publike, fuqizimin e organeve ekzekutive por edhe atyre përfaqësuese në nivelin vendor. Një vëmendje e veçantë iu kushtua forcimit të rolit të Këshillit Konsultativ midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore gjatë procesit të përpilimit të projekt-akteve që afektojnë qeverisjen vendore para miratimit të tyre. Në këtë proces janë përfshirë gjithmonë e më shumë përfaqësues të qeverisjes vendore gjë që ka përmirësuar ndjeshëm vendimmarrjen. AMVV ka siguruar në vijimësi partneritetin e nevojshëm të institucioneve të vendit, projekteve të mbështetura nga donatorë të huaj për përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të reformës së decentralizimit dhe për konsolidimin apo futjen e praktikave të reja në ushtrimin e funksioneve dhe shërbimeve që u ofrohen qytetarëve nga NJVV. Në të njëjtën kohë AMVV ka qenë e përfshirë në hartimin e dokumentave të ndryshëm strategjikë apo edhe ligjor, si kontribuese për aspekte të qeverisjes vendore edhe në kuadër të procesit të integritit evropian.

Drejtori i përgjithshëm


Enea HOTI

KAPITULLI I

Struktura dhe buxheti.

Organograma dhe struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit nr.68, datë 05.05.2015, “Për miratimin e strukturës së Agjencisë së zbatimit të Reformës Territoriale”, ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 82, datë 12.05.2016 dhe me urdhrin nr.17 datë 18.01.2021. Struktura dhe organika e AMVV-së, aktualisht përbëhet nga 14 punonjës dhe 1 punonjës me kontratë provizore. Organograma dhe struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, për vitin 2021 është ndryshuar nga 2 sektorë në 3 sektorë me të njëjtin numër punonjësish 14.

1. Sektori e Koordinimit me Qeverisjen Vendore;
2. Sektori i Mbështetjes Institucionale;
3. Sektori i Zhvillimit.



Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Kriteret specifike dhe procedurat e pranimit në punë bëhen sipas nenit 14 të rregullores të brendshme të AMVV-së, miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm.nr.332 datë 26.10.2022.

Për vitin 2021 janë bërë disa trajnime për ngritjen profesionale të punonjësve si:

Trajnim për prokurimet publike të zhvilluar nga ASPA.

Trajnim për Sinjalizimin e Korrupsionit dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve.

Trajnim për pikat e kontaktit antikorrupsion.

Planifikimi dhe realizimi buxhetit për vitin 2021.

Për vitin 2021 planifikimi dhe realizimi i buxhetit të AMVV-së është sipas tabelës.

NR.LLOGARIVE	EMËRTIMI	ÇELJE NË FILLIM & SHTESA	FAKTI MË 31/12/2021	FONDE TË DERDHURA NË BUXHET	% REALIZIMIT TË BUXHETIT
602	SHPENZIMET OPERATIVE	12,000,000	9,715,032	2,284,968	80
600	PAGAT	15,125,000	12,158,507	2,966,493	80
601	SIGURIMET SHOQËRORE & SHËNDETSORE	2,178,000	1,922,187	255,813	88
231	PROJEKTI STAR 2	10,000,000	10,000,000	0	100
231	RIMBURSIM TVSH BASHKITË E FORTA	20,000,000	20,000,000	0 -	100
SHUMA TOTALE		59,303,000	53,795,726	5,507,274	90

Mosrealizimi i buxhetit është për arsye:

- Vendet vakante të pesë punonjësve të AMVV-së, periudha për punësimin e tyre 2 mujore (procesit të konkurimit dhe shpallja e fituesit)

Shërbimi i automjeteve nuk u zhvillua për vitin 2021, për arsye të mosrealizimit të procedurës së Prokurimit (tërheqjes së operatorëve ekonomikë në tre procedura prokurimi).

KAPITULLI II

II-1. Integrimi Evropian dhe bashkëpunimi me Projektet

Qeverisja vendore ka rëndësi të veçantë në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë dhe përbën element thelbësor në demokratizimin e vendit si dhe në intensifikimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Pa një sistem solid, të qëndrueshëm, të efektshëm të qeverisjes vendore nuk mund të konsiderohet i plotë dhe thellësisht demokratik sistemi politik i vendit. Pushteti vendor luan rol kyç për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Acquis Communautaire për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin Evropian dhe zbatimin e tij. Rreth 70 % e legjislacionit të Bashkimit Evropian do të duhet të zbatohet saktë, në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë nga pushteti vendor.


Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me rrjetin e punonjësve të zyrave të Integrimit të BE-së, në 61 bashki ka forcuar përfshirjen e NJVV-ve në procesin e integrimit në BE, duke rritur ndërgjegjësimin mbi politikën e BE-së, *acquis-në* e BE-së, fondet dhe programet e saj. Zbatimi i vendimit të Këshillit të Ministrave i korrikut të vitit 2018, i cili institucionalizon dhe përditëson të ashtuquajturat "tryeza të BE-së" me "njësitë e BE-së" është përmbushur pothuajse plotësisht. Në janar të vitit 2021 u prezantua një raport i dytë mbi performancën e bashkive për integrimin në BE-së, në të cilin referohet dhe progresi i raportit të integrimit në BE. Ministria e Brendshme si ministri përgjegjëse për pushtetin vendor, është angazhuar nëpërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për ta bërë këtë ushtrim një proces të rregullt vjetor nën drejtimin e vet.

II-2. Bashkëpunimi me projektin “Bashkitë për në Evropë, Delegacioni Evropian”.

II-2/a. Njësitë e Integrimit Evropian

Projekti Bashkitë për në Evropë, është një nismë e Bashkimit të Evropian, e cila synon të rrisë kapacitetet e Njësisë të Qeverisjes Vendore në Shqipëri në kuadër të procesit të integrimit evropian të vendit, duke ngritur në secilën bashki një zyrë të BE që do të jetë edhe pika e referencës në çdo bashki, jo vetëm për punonjësit e administratës vendore, por edhe për të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit në nivel vendor. Projekti BpE synon forcimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore në lidhje me BE-në dhe nevojën për të angazhuar më shumë nivelin vendor në komunikimin e lidhur me BE-në.

AMVV në bashkëpunim me Projektin BpE kanë qënë mbështetës dhe ndihmues në procesin e ngritjes dhe konsolidimit të zyrës së Njësisë së Integrimit Evropian në çdo bashki. Këto zyra vite më parë u hapën si kënde të BE për informimin e qytetarit dhe sot me ndihmën e BpE, janë konsoliduar Njësitë e Integrimit Evropian si struktura bazë të bashkisë. Në fillim të shtatorit 2021, Projekti ofroi asistencë për AMVV dhe EUDAL për shpërndarjen e pajisjeve të TI-së të dhuruara nga BE-ja në 44 bashki.



Për vitin 2021 janë përfunduar 74 projekte të zbatuara me sukses nga bashkitë. Tirana është në vendin e parë me 21 aplikime, e ndjekur nga Lezha me 9 aplikime dhe Kukësi me 8 aplikime. 14 bashki nuk kanë aplikuar për asnjë nga grantet dhe projektet e ofruara nga Bashkimi Evropian. Realizimet janë kryer në kuadër të programeve IPA CBC CfP, Union Programs (Horizon 2020, Erasmus+, Europe for Citizens, Creative Europe). Ndërkohë, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë aplikuar gjatë vitit 2021 në thirrjet e BE-së të dedikuara për bashkitë shqiptare në kuadrin e dy programeve: BE-së për zhvillimin social-ekonomik dhe - partneritetet në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale.

II-2/b. Organizimi i seminarit për rolin e bashkive në implementimin e Acquis dhe korniza institucionale e strukturave të integritit evropian në nivel vendor me ekspertë ndërkombëtarë nëpërmjet TAIEX.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me projektin Bashkitë për në Evropë trajtoi çështjet për diskutim me ekspertët e TAIEX mbi aktivitetet në pritje të pa organizuara për shkak të situatës pandemike dhe përgatitjen e aplikimeve të reja në kuadrin e mbështetjes TAIEX për Ballkanin Perëndimor programi 2021-2022.

Kushtëzuar nga situata e shkaktuar nga pandemia COVID-19 mbeten për t'u zhvilluar dy aplikime nga edicionet e zhvilluara të cilat janë aktualisht në ndjekje. Në lidhje me workshop-in mbi "Rolin e bashkive në procesin e Integritit Evropian", Agjencia është ende në pritje të konfirmimit nga përfaqësuesit e TAIEX. Bazuar në konsultimet me projektin, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në takimin online të organizuar me përfaqësues të TAIEX në dhjetor të 2021, ka paraqitur një draft-agjendë për trajnimin, për çështjet e integritit evropian në nivel vendor. TAIEX do të vazhdojë gjatë vitit 2022 me detajet për organizimin e trajnimit.

II-3. Matrica e Performancës së Bashkive në kuadër të Integritimit Evropian.

Për vitin 2021, është realizuar procesi i hartëzimit/mapping për matricën e performancës, procesi i cili realizohet periodikisht. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me projektin Bashkitë për në Evropë kanë menaxhuar procesin e Vlerësimit të Performancës në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga integrimi evropian.

Procesi i hartëzimit së vitit 2021 filloi në mesin e tetorit 2021 me organizimin e takimeve me Njësinë e Departamentit të Programimit, ekspertët e hartës dhe ekipin e projektit Bashkitë në Evropë. Rekomandimi për fillimin e procesit të hartografisë së vitit 2021 dhe kalendari u përditësuan më 26 tetor 2021. Më 12 nëntor 2021 u zhvillua në Tiranë seminari informues me 61 drejtuesit e strukturave të Njësive të Integritimit Evropian në bashki. Qëllimi i sesionit informues ishte vërtetimi i treguesve të përfshirë në Matricën e Hartëzimit të Treguesve 2021.

AMVV nisi zyrtarisht procesin e hartëzimit së vitit 2021 më 18 nëntor 2021, me rekomandimet përkatëse dhe matricën dërguar të 61 kryetarëve të bashkive. Duke marrë parasysh një numër të madh të stafit të ri, trajnimi online për stafin e ri të Njësive të Integritimit Evropian për përgatitjen e Procesit të Hartëzimit u zhvillua më 9 dhjetor 2021. Përveç kësaj, strukturave përgjegjëse për integrimin evropian në njësitë e vetëqeverisjes vendore, iu ofrua mbështetje praktike gjatë dhjetorit nga Agjencia, projekti dhe eksperti i IT-së për bazën e të dhënave të hartës për të lehtësuar raportimin e treguesve të hartës.

Procesi i hartëzimit, pasi u konsultua me ekspertët e përfshirë, u përcoll pranë delegacion të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Sfidë për t'u realizuar është konsolidimi i Njësive të Integritimit me staf të qëndrueshëm në strukturë të bashkisë.

Nisur nga detyrat funksionale të sektorit të zhvillimit, në mënyrë grafike është paraqitur orientimi dhe realizimi i aplikimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për projektet e financuara nga Bashkimi Evropian përgjatë vitit 2021.

Kapitulli III

Praktikat e Mira

Në përmbushje të gërmës ë, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.83 datë 28.1.2015 “Për Krijimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, ku Agjencia shërben si qendër e evidentimit dhe e promovimit të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore, në muajin nëntor është bërë shpallja e edicionit të replikimit të praktikave të mira të bashkive. Agjencia me mbështetjen e programit “Bashki të Forta” është angazhuar në hartimin e një plan- veprimi me hapa konkretë dhe kalendar aktivitetesh që do të bëjnë të mundur përthithjen e këtyre praktikave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të interesuara. Proçesi ka nisur prej tetorit të vitit 2021 dhe përfundon në muajin qershor 2022. Së bashku me ekspertët e projektit është bërë e mundur përzgjedhja e 10 praktikave sipas metodologjisë: (I) Inovacion, (II) Ndërveprim bashki-komunitet, (III) Kosto, (IV) Përmirësim i shërbimeve.

Në fazën e parë janë përzgjedhur praktikat nga edicionet e konkursit të Praktikave të Mira 2018 dhe 2020.

a. Bashkia Dimal “Rritja e të ardhurave vendore nëpërmjet sistemit informatik E-Bashkia”

Bashkia Dimal ka nisur zbatimin e implementimit të sistemit, i cili ka një impakt të jashtëzakonshëm në veprimet institucionale. Regjistri i taksapaguesve, tregon në kohë reale për çdo punonjës dhe njësi administrative, detyrimet e çdo individit. Gjenerohen raporte ekonomike për zyrën e financës, zyrën e të ardhurave, ujësjellësin si dhe çdo vërtetim që lëshohet nga institucioni. Përveç shërbimeve, ofrohet edhe plotësimi i kërkesë - ankesave në çdo moment pa qenë e nevojshme paraqitja në bashki.

Kjo platformë është një sistem i integruar informatik, inovativ, i cili mund të implementohet edhe në njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore. Inovacioni i tij kryesor, është kontakti i qytetarit me bashkinë dhe shërbimet që i ofrohen 24 orë në ditë, pa qenë e nevojshme të paraqitet në bashki.

b. Bashkia Elbasan “Rritja e sigurisë në sistemin arsimor nëpërmjet gjurmimit të rasteve”

Për herë të parë në Bashkinë Elbasan është zbatuar ky projekt nga këshilli vendor për sigurinë publike, i cili ka identifikuar si nevojë për siguri më të mirë instalimin e kamerave në çerdhet, kopshtet dhe në ambjentet e shkollave të arsimit 9-vjeçar dhe të arsimit të mesëm të përgjithshëm. Zbatimi i këtij projekti i siguron komunitetit ruajtjen deri në 60 ditë të pamjeve filmike, vëzhgimin pamor 24 orë të ambjenteve të jashtme të perimetrit të shkollës.

Implementimi i këtij projekti ofron siguri publike nëpër shkolla, rrit menaxhimin efektiv të respektimit të orarit dhe frekuentimit të orëve të mësim, shmang konfliktet fizike, rrit besimin

komunitar, si pasojë e rritjes së partneritetit publik midis institucioneve, prindërve dhe stafit pedagogjik. Bashkia Elbasan nëpërmjet projektit: "Pajisje me kamera sigurie e objekteve arsimore dhe institucioneve publike në varësi të Bashkisë Elbasan dhe mirëmbajtja e tyre" ka përdorur mjete të ndryshme të komunikimit si: takime me drejtorinë rajonale arsimore, takime me drejtues të shkollave të arsimit parauniversitar, senatet e shkollave, bordet e prindërve etj. Për të identifikuar prioritetet komunitare sipas fushave të zhvillimit janë realizuar 3 takime me përfaqësues të këshillit vendor për sigurinë publike, nga ku kanë marrë pjesë 24 përfaqësues nga të cilët 35% gra. Më pas implementimi i këtij projekti ka mundësuar jo vetëm rritjen e sigurisë publike në menaxhimin e këtij shërbimi por edhe në rritjen e besimit komunitar në masat e marra ndaj çdo problematike të identifikuar në qytet apo në territoret e shkollave, kopshteve apo çerdheve të territorit administrativ të bashkisë Elbasan.

c. Bashkia Mirditë “Turizmi kulturor në zonat e thella malore, ngritja e infopoint”

Ngritja e kësaj qendre është tërësisht inovative. Nga Agjencia Kombëtare e Turizmit është vlerësuar si më e mira infopoint në Shqipëri. Ndërsa përsa i përket llojit dhe mënyrës së konceptimit të saj vlerësohet si e para në Ballkan. Ngritja e qendrave të dedikuara të turizmit, por edhe shërbimeve të tjera, është e domosdoshme të krijohet në secilën nga bashkitë pasi jep mundësinë e krijimit të sinergjive vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare duke unifikuar për një qëllim institucione publike e private, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe individë e komunitete. Komuniteti është përfshirë direkt në funksionimin e kësaj qendre. Konsultimet e shumta për krijimin e produkteve dhe ofertave turistike me banorët lokal kanë qenë të vazhdueshme. Gjithashtu nëpërmjet mediave sociale të vëna në dispozicion është bërë i mundur komunikimi dhe informimi për iniciativa të ndryshme. Një tregues i përfshirjes së komunitetit është interesimi i vazhdueshëm i tyre për ecuritë e mëtejshme të zhvillimit të turizmit malor. Interesim të lartë ka patur dhe për mundësinë e kthimit të kullave tradicionale në shtëpi pritëse si dhe për mundësitë e aplikimit në programet qeveritare dhe jo qeveritare të granteve dhe projekteve.

d. Bashkia Has “Mbrojtja e pyjeve nga zjarret, krijimi i grupeve vullnetare”

Janë organizuar disa takime ndërgjegjësuese me aktorët vendorë me qëllim sensibilizimin për rolin e tyre në kushtet e reja të krijuar në kuadër të decentralizimit dhe të transferimit të kompetencave për pyjet tek pushteti vendor. Gjithashtu janë organizuar edhe takime me strukturat vendore të bashkisë Has ku është diskutuar rreth problemeve edhe mundësive të plotësisht të nevojave të popullatës dhe institucioneve publike me dru-zjarri apo produkte të biomasës. Janë organizuar takime me kryetarët e fshatrave dhe komunitetin, për të kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve dhe krijimin e grupeve vullnetare për të shmangur katastrofat natyrore dhe zjarrvënien e qëllimshme. Ky projekt, ka bërë të mundur ndërveprimin eficient të bashkisë me komunitetin, si një shembull për tu ndjekur dhe promovuar edhe për bashkitë e tjera.

Janë pilotuar 2 modele për studimin e gjendjes ekzistuese të dushkajave dhe shkurreve duke synuar ruajtjen e ekuilibrave midis prodhimit të produkteve drusore e jo drusore dhe funksioneve ekologjike.

e. Bashkia Tropojë “Mekanizma ndikimi për financim dhe vendimmarrje për çështjet gjinore dhe sociale”

Bashkia Tropojë ka një numër të madh të pastrehësh në territorin e vetë. Investimi i kryer në bashkëpunim me shoqatën austriake “Albania-Austria Partnerschaft” në godinën e ish hotelit të punëtorëve, e transformoi atë në bllok banesash sociale, duke strehuar kështu 15 familje me total përfituesish prej 74 personave.

Rezultatet e kësaj praktike janë shumë të rëndësishme në vazhdimësinë dhe integrimin e praktikave të ngjashme duke menduar dhe punuar për të ndërtuar sërish banesa sociale për të ulur sadopak numrin e të pastrehëve në Tropojë. Kjo praktikë është risi në kulturën e institucionit pasi është hera e parë që bashkia Tropojë ndërton banesa sociale. Për të siguruar qëndrueshmërinë e kësaj praktike bashkia do të kujdeset që të mirëmbajë këtë objekt.

f. Bashkia Kavajë “Edukimi qytetar në arsimin parashkollor, për trajtimin e mbetjeve”

Edukimi mjedisor është i integruar në kurrikulën arsimore si tematikë, por duke u limituar në zhvillimin e zakonshëm të orës mësimore dhe disa veprimtarive praktike që nuk kanë impakt të gjerë në komunitet. Duhet theksuar që edukimi mjedisor në kurrikulën shkollore është me rëndësi për zhvillimin e aftësive konjitive, sociale e përgjegjësive civile të nxënësve pasi bën të mundur që ata të angazhohen në çështje përtej ambienteve të shkollës, duke qënë kreativë në zgjidhjen e problemeve dhe mbrojtës të çështjeve mjedisore. Kjo praktikë synon rritjen e njohurive të fëmijëve mbi mjedisin dhe të drejtat mjedisore, si dhe nëpërmjet veprimeve konkrete nga vetë ata për t'i vënë në pah kontributin dhe ndihmën që ata mund të japin për këtë dukuri. Në kushtet e ndodhura futja e konceptit të riciklimit është një instrument me rëndësi të veçantë. Fokusi u përqëndrua në aksiomën edukim nëpërmjet argëtimit, duke zbatuar aktivitete dhe ushtrime argëtuese, për të realizuar ndarjen e mbetjeve dhe riciklimin. Kjo praktikë e cila rezultoi aq efektive mendohet të implementohet më gjerësisht akoma në të gjithë sistemin parashkollor, për të nisur kështu hapat e para drejt një fushate sensibilizuese ndaj të gjithë komunitetit dhe bashkisë së Kavajës.

g. Bashkia Lezhë “Menaxhimi i mbetjeve në zonat turistike”

Kjo praktikë është në përputhje me Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2017-2021, i cili është i hartuar në përputhje me qëllimet dhe afatet që parashikohen nga ligjet sektoriale të vendit, si Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, gjithashtu, në përputhje me Rregulloren për Monitorimin e Planit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta, i cili ndiqet në vijueshmëri nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, bashkia Lezhë.

Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve është realizuar pas disa dëgjësive publike të realizuara nga ana e Bashkisë Lezhë me shoqërinë civile, komunitetin e biznesit si dhe banorët e të gjitha njësive administrative. Ndërhyrja për menaxhimin e mbetjeve në Shëngjin gjatë

sezonit veror 2020, është bërë pas konsultimeve dhe dëgjësive publike me palët e interesuara. Në përfundim kjo praktikë ka rezultuar e suksesshme, duke ofruar një shërbim më të mirë në menaxhimin e mbetjeve. Në zonën e Shëngjinit gjatë sezonit të verës, ishte e domosdoshme ndërhyrja për grumbullimin e mbetjeve derë më derë për bizneset dhe me orare të përcaktuara për banorët, kjo shoqëruar edhe me shtimin e numrit të konteinerëve që ka sjellë rezultat duke e bërë këtë praktikë të suksesshme.

Rezultatet kryesore të kësaj praktike kanë qenë:

- Mbulimi i territorit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane nga 56 % në vitin 2016, në 97 % në vitin 2020 në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë, me një numër prej 960 konteinerësh dhe 565 PGM (Pika të Grumbullimit të Mbetjeve) për një popullësi prej 13 535 banorësh sipas regjistrimit të gjendjes civile.
- Bashkëpunimi i bashkisë Lezhë me operatorët turistikë, bizneset dhe qytetarët për grumbullimin dhe evadimin e mbetjeve derë më derë dhe me orare të përcaktuara, ka bërë të mundur që pastrimi i zonës së Shëngjinit të jetë në nivele shumë të kënaqshme.
- Grumbullimi i mbetjeve derë më derë është shoqëruar me pastrimin e ambienteve të rrugëve kombëtare dhe rajonale, të hapësirave publike dhe jo vetëm, me dezinfektimin dhe larjen e konteinerëve dhe hapësirave përreth PGM-ve ka sjellë një mjedis më miqësor dhe me kushte optimale.

h. Bashkia Korçë “Qyteti i Fëmijëve”

Prej më shumë se 10 vitesh Bashkia Korçë ka ndërtuar një program të veçantë të quajtur “Qyteti për Fëmijët”, pjesë e të cilit çdo vit kanë qenë një paketë projektesh dedikuar fëmijëve. Në përmbushje të këtij vizioni kjo paketë projektesh u pasua në vitin 2019 me projektin më të madh për fëmijët: Ndërtimin e Qytezës së Fëmijëve, një hapësirë prej 3476 m². Qyteza e fëmijëve është e para dhe e vetmja qendër e përmasave të tilla në të gjithë rajonin, e cila prej një viti tashmë ofron shërbime për fëmijë 3-14 vjeç, nëpërmjet misionit të saj social, edukues dhe argëtues. Qyteza erdhi si një zgjidhje për zhvillimin jashtëshkollor të fëmijëve dhe të rinjve të rajonit të Korçës, duke krijuar platforma specifike me kushte dhe shërbime bashkëkohore për të lehtësuar zhvillimin e fëmijëve në fushat e artit, sportit dhe shkencës. Platforma zhvilluese e qytezës përqëndrohet tek zhvillimi intelektual, social, emocional dhe fizik i fëmijëve. Misioni social i qytezës është kontributi tek vlerat komunitare të këtij qyteti duke u bazuar mbi bashkëpunimin e pandërprerë me të gjithë aktorët rajonalë, komunitetin e prindërve, grupet e interesit dhe organizatat e ndryshme me fokus zhvillimin e fëmijëve.

i. Bashkia Maliq “E-Pjesëmarrja qytetare, aleanca qytetar-këshilltar”

Suksesi i praktikës së Këshillit Bashkiak të Maliqit, pra ngritja e mekanizmit nxitës të përfshirjes së publikut në vendimarrje, duke shfrytëzuar teknologjinë e informacionit e ka çelësin tek bashkëpunimi dhe koordinimi i punës midis disa institucioneve dhe aktorëve. Së pari ngelet për tu vlerësuar bashkëpunimi institucional midis këshillit dhe ekzekutivit, i cili

mundësoi krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe logjistike. Zbatimi i kësaj praktike, dha rezultate të vlefshme për qytetarët, pasi ka nxitur përfshirjen e tyre si dhe ka rritur transparencën. Plotësimi online i pyetësorëve, përfshirja në konsultime, dhënia e mendimeve për çështje të ndryshme, shpërndarja e informacionit, janë vetëm disa nga elementët pozitivë të përdorimit të platformës online, me qëllim nxitjen dhe përfshirjen e komunitetit.

j. Bashkia Shkodër “Kostimi i shërbimit të mbetjeve”

Miratimi i Planit Lokal të Menaxhimit të mbetjeve për bashkinë Shkodër dhe zbatimi i plan veprimeve të detajuara ndikoi në përmirësimin e metodologjisë të zbatimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit të shërbimit të pastrimit në territorin e bashkisë Shkodër. Me zbatimin e këtij sistemi u ngritën dhe u forcuan kapacitetet e strukturave të monitorimit dhe raportimit të shërbimit të pastrimit në lagjet dhe njësitë administrative. Proçesi i monitorimit të shërbimit të pastrimit pasqyrohej në formatet e monitorimit dhe raportimit bazuar frekuencës të shërbimit të pastrimit. Këtë shërbim Bashkia Shkodër e përfiton nga marrëveshjet kontraktuale me të tretët. Me anë të formateve ditore të raportimit inspektorët dhe administratorët në të gjitha njësitë administrative adresojnë problematikën e hasur gjatë monitorimit të shërbimit në njësinë e monitorimit të shërbimeve publike. Monitorimi dhe raportimi sigurojnë kontrollin e zbatimit referuar elementëve bazë të kontratës/kontratave që Bashkia Shkodër ka me operatorin/ operatorët sipërmarrës. Proçesi i raportimit nga njësitë administrative në Bashkinë Shkodër realizohet nëpërmjet dërgimit të formatit të monitorimit dhe raportimit nga zyrat e integruara me një ndalesë të njësisive administrative. Sistemi i zyrës të integruar me një ndalesë gjeneron dokumentacionin dhe e dërgon brenda afatit të përcaktuar në procedurë në zyrën e protokoll-arkivës.

Në datën 22.11.2021 u prezantua në aktivitetin e posaçëm të zhvilluar fillimi i proçesit të përhapjes së praktikave të mira, ku njësitë e vetëqeverisjes vendore, pasi u njohën me dhjetë praktikën e përzgjedhura, në mënyrë transparente shprehën interesimin më të madh për praktikën e bashkive Dimal, Lezhë dhe Has. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, grumbulloi formularët e shprehjes së interesit, për të vazhduar më tej në cilësinë e garantuesit të proçesit, me nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet bashkive Has, Dimal dhe Lezhë me bashkitë replikuese.

Aktualisht kanë shprehur interes 25 bashki ndërsa proçesi është në vazhdim dhe përmbyllet në fundin e muajit qershor të vitit 2022.

KAPITULLI IV

Monitorimi i planeve të integritetit në nivel vendor

Për sa i përket planeve të integritetit në nivel vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në rolin e saj koordinues me bashkitë, monitoron miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit në nivel bashkie. Gjithashtu, Agjencia ka qenë pjesë e procesit të hartimit dhe konsultimit të këtyre planeve në disa grupe pune. Mbështetja teknike, për sa i përket orientimit metodologjik, është dhënë nga projekti STAR 3, një projekt me të cilin Qeveria Shqiptare është në bashkëpunim të vazhdueshëm. Më saktësisht, bashkive u është rekomanduar një metodologji për hartimin e Planit të Riskut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes. Kjo përfshin (a) përgatitjen e metodologjisë së Planit të Riskut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes, si dhe (b) hartimin, proceset e konsultimit, shqyrtimin dhe finalizimin e dokumenteve të sipërpërmendura.

Për sa i përket miratimit të planit të integritetit, bashkitë e mëposhtme kanë miratuar këto plane me Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB);

1. Patos, miratuar me VKB nr. 82, datë 13.12.2019;
2. Elbasan, miratuar me VKB nr. 04.12.2019;
3. Mallakastër, miratuar me VKB nr. 109, datë 20.12.2019;
4. Mat, miratuar me VKB nr. 59, datë 24.12.2019;
5. Gjirokastrë, miratuar me VKB nr. 11, datë 31.01.2020;
6. Durrës, miratuar me VKB nr. 127, datë 28.10.2021;
7. Belsh, miratuar me VKB nr.10, datë 31.01.2022;
8. Berat, miratuar me VKB nr. 9, datë 02.03.2022;
9. Bulqizë, miratuar me VKB nr. 300, datë 01.02.2022;
10. Lezhë, miratuar me VKB nr. 32, datë 04.04.2022;
11. Përmet, miratuar me VKB datë 31.01.2022;
12. Pogradec, miratuar me VKB nr. 18, datë 18.02.2022;
13. Tiranë, miratuar me VKB nr. 35, datë 06.04.2022.

Nëpërmjet Projektit STAR 3, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka ndihmuar në hartimin e planeve të veprimtimit. Janë mbajtur sesione informuese për çështjet që bashkitë i kanë ngritur gjatë zbatimit të planeve të integritetit. Në fund të dhjetorit 2021, gjashtë plane integriteti u finalizuan dhe u prezantuan në Këshillat Bashkiakë të Tiranës, Progradecit, Beratit, Përmetit, Belshit dhe Lezhës. Përveç kësaj, dy plane shitesë për integritetin janë duke u hartuar dhe pritet t'i nënshtrohen një diskutimi përfundimtar me IWG-në përkatëse.

Për sa i përket zbatimit, Agjencia është duke u koordinuar me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) që kanë miratuar tashmë një Plan Integriteti, për të monitoruar zbatimin e tij gjatë vitit 2021. Kështu, procesi i monitorimit të zbatimit të planit të veprimit u fokusua në bashkitë Mat. , Gjirokastrë, Elbasan, Patos dhe Mallakastër. Kuadri analitik për vlerësimin e zbatimit të planeve të integritetit në nivel vendor përfshin tre fusha kryesore, të cilat përbëjnë bazën kryesore për vlerësimin e planeve të integritetit në bashkitë e përzgjedhura.

1. Fusha e parë: Sistemi i menaxhimit të integritetit në institucion - Proçese dhe rregulla të qarta - 15 tregues.

2. Fusha e dytë: Burimet njerëzore të përshtatshme, të kualifikuara dhe të trajnuara për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit - 11 tregues.

3. Fusha e tretë: Transparencë më e lartë e bashkisë me publikun dhe aktorët e interesuar - 11 tregues.

Informacioni mbi monitorimin e zbatimit të planeve të integritetit sipas zonave u mbledh nëpërmjet një pyetëso, i cili shërbeu si një udhëzues për përgjigjet e të intervistuarve ose punonjësve të përfshirë në grupe duke përdorur intervista të strukturuar ose gjysmë të strukturuar, të cilat standardizuan informacionin e mbledhur për të tre fushat kryesore në 37 tregues. Treguesi i vlerësimit të zbatueshmërisë së planit të integritetit për një bashki varion nga 0% në 100% duke vlerësuar shkallën e zbatimit të planit të integritetit.

Për sa i përket rezultateve, bashkitë janë ndarë në pesë grupe që korrespondojnë:

I. Bashkitë me nivel josistematik të zbatimit të planit të integritetit - Niveli Ad-hoc (Indeksi i zbatueshmërisë së Planeve të Integritetit merr vlerë deri në 61%).

II. Bashkitë me nivelin bazë të zbatimit të planit të integritetit - Niveli bazë (ndryshon nga 61% në 69%)

III. Bashkitë me nivel zbatimi të mirë-menaxhuar të planit të integritetit - Niveli i menaxhuar (ndryshon nga 69.1% në 86%)

IV. Bashkitë me nivel të avancuar zbatimi - Niveli i avancuar (ndryshon nga 86.1% në 94%)

V. Bashki me nivel zbatimi të qëndrueshëm dhe të maturuar të planit të integritetit (ndryshon nga 94.1% në 100%).

Sipas performancës në zbatimin e masave të Planit të Integritetit gjatë vitit 2021, bashkitë renditen si më poshtë:


1. Bashkia Elbasan: 78% - Niveli i menaxhuar.

2. Bashkia Mat: 74.6% - Niveli i menaxhuar.

3. Bashkia Patos: 74% - Niveli i menaxhuar.

4. Bashkia Mallakastër: 65.6% - Niveli bazë.


5. Bashkia Gjirokastrë: 44.6% - Niveli ad hoc.



Tre bashkitë e renditura më mirë (Elbasani, Mati dhe Patosi) kanë rezultuar në një nivel të menaxhuar të zbatimit të masave të Planit të Integritetit, duke treguar se janë ndërmarrë hapa pozitivë për përmirësimin e transparencës, kuadrin rregullator për përmirësimin e menaxhimit të sistemit të integritetit, si dhe duke bërë përpjekje për njohjen e stafit me Planin e Integritetit. Ndërsa në dy bashkitë e tjera, Mallakastër dhe Gjirokastrë, progresi ka qenë i kufizuar.


Tema 1: Funkionimi i sistemit të integritetit në bashki duke ofruar një kuadër rregullator të brendshëm pro integritetit.

Monitorimi i bashkive në lidhje me temën 1, siç paraqitet në figurën 2, tregoi se zbatimi i kësaj teme është në nivel të avancuar në një bashki (Patos), në nivel të menaxhuar në tre bashki (Elbasan, Mallakastër dhe Mat) dhe në një nivel bazë në një bashki (Gjirokastrë).




Tema 2: Burimet njerëzore të përshtatshme, të kualifikuara dhe të trajnuara për t'u marrë me shkeljet e integritetit.

Monitorimi i bashkive në lidhje me temën 2, siç paraqitet në figurën 3, tregoi se zbatimi i këtij objekti është në nivel bazë në një bashki (Elbasan) në nivel ad hoc në katër bashki (Mat, Patos, Mallakastër dhe Gjirokastrë).



Tema 3: Transparencë më e lartë e bashkisë me publikun dhe grupet e interesit

Monitorimi i bashkive në lidhje me temën 3, siç paraqitet në figurën 4, tregoi se zbatimi i këtij objekti është maturuar në një bashki (Patos), është në një nivel të avancuar në dy bashki (Elbasan dhe Mat), në një nivel të menaxhuar në një bashki (Mallakastër) dhe në nivel ad hoc në një bashki (Gjirokastrë).



Për ta përmbledhur, shkalla e përgjithshme e zbatimit të pesë bashkive të përzgjedhura është llogaritur si një mesatare aritmetike e të gjithë shkallës së zbatimit. Konkretisht, bazuar në shkallën e zbatimit të bashkisë Elbasan (78%), Mat (74.6%), Patos (74%), Mallakastër (65.6%), Gjirokastrë (44.6%), shkalla e përgjithshme e zbatimit për vitin 2021 është 67.36%.

Konkluzion :Të paktën 75% e ministrive kanë miratuar një plan integriteti dhe të paktën 3 bashki të tjera kanë zbatuar një plan vendor të integritetit në krahasim me vitin 2020.

KAPITULLI V

Këshilli Konsultativ

Këshilli Konsultativ është forum konsultues ndërmjet qeverisë qendrore dhe vetëqeverisjes vendore. Me qëllim institucionalizimin e procesit të konsultimit mes vetëqeverisjes vendore dhe qeverisjes qendrore, Këshilli Konsultativ ka për objekt konsultimi të gjitha projektligjet, projektvendimet e Këshillit të Ministrave, projekt-politikat dhe projekt-strategjitë që rregullojnë ose kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Synimi afatgjatë i krijimit dhe konsolidimit institucional të kësaj strukture është shndërrimi i organeve të vetëqeverisjes vendore në partnerë të rëndësishëm të qeverisjes qendrore për fushat e tyre të përgjegjësisë dhe të drejtave që gëzojnë. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është ngarkuar të kryejë detyrën e sekretariatit teknik të këtij këshilli.

Procesi i konsultimit në Këshillin Konsultativ bazohet në:

- a. Parimin e informimit, nëpërmjet njoftimit dhe vënies në dispozicion të anëtarëve të Këshillit Konsultativ, shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nëpërmjet tyre, të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore për projektligjet, projektvendimet, projekt-politikat ose projekt-strategjitë që propozohen nga qeverisja qendrore;
- b. Parimin e këshillimit, nëpërmjet shkëmbimit të mendimeve, komenteve, vërejtjeve dhe propozimeve për projektligjet, projektaktet, projekt-politikat ose projekt-strategjitë të propozuara nga qeverisja qendrore dhe që kanë ndikim në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- c. Parimin e angazhimit të shoqatave përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të vetë këtyre njësive, si dhe rritjen e transparencës, nëpërmjet përfshirjes së tyre në procesin e formulimit dhe miratimit të projektakteve, politikave dhe zgjidhjeve konkrete;
- ç. Parimin e bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv me të gjithë shoqatat përfaqësuese të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në këtë raport, veprimtaria e Këshillit është përshkruar nëpërmjet dy grupe treguesish të cilët përfaqësojnë drejtimit kryesorë të funksioneve të tij dhe janë objekt i analizës vjetore të performancës së efektivitetit të tij.

Diskutim i projekt akteve ligjore/nenligjore

Grupi i parë janë treguesit të cilët përshkruajnë veprimtarinë e Këshillit gjatë vitit 2021 në lidhje me projekt aktet ligjore të paraqitura në Këshill për diskutim, të diskutuara, të pa diskutuara, të miratuara e të pa miratuara. Përqindja e projekt akteve ligjore të diskutuara përlllogaritet përkundrejt numrit të atyre të paraqitura për diskutim, dhe përqindja e projekt akteve ligjore të miratuara, përkundrejt numrit të atyre që diskutohen.

Grupi i dytë janë treguesit të cilët përshkruajnë ecurinë e zbatimit të harmonizimit ligjor në vijim të urdhrat të Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019, “Për hartimin e akteve nënligjore nga ministritë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara njësisive të vetëqeverisjes vendore” dhe duke vijuar me rekomandimet e matricës së kompetencave për vitin 2021.


Gjithashtu, ky grup përfshijë tregues të cilët përshkruajnë nivelin e përfaqësimit në mbledhjet e Këshillit të anëtarëve të saj nga Qeveria Qendrore dhe ajo Vendore. Niveli i përfaqësimit mbi bazën e të cilit janë ndërtuar këta tregues është ai i cili i ngarkohet anëtarëve të Këshillit sipas VKM-së nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në dy drejtime kryesore:

- (i) prania në mbledhje;
- (ii) niveli hierarkik i përfaqësuesit.

Konsultimi i projekt akteve ligjore

Gjatë vitit 2021 janë paraqitur për diskutim gjithsej 50 projekt-akte ligjore ndër të cilat 47 akte janë konsultuar në mbledhjet e këshillit. Për nga aktet janë 5 projektligje, 42 projektvendime dhe 3 projekt udhëzime. Këto projekt-akte ligjore janë paraqitur kryesisht nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 13 prej tyre, e më tej 12 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 7 nga Ministria e Mbrojtjes, 8 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe 5 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2 nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 2 nga Ministria e Kulturës, 1 nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës dhe 2 nga Ministria e Brendshme. Gjithashtu janë sjelle 3 raporte nga Shoqata për Autonominë Vendore, 3 prezantime nga organizata të vendit dhe 5 prezantime nga Kryeministria. Nga 50 akte të konsultuara në Këshill, 47 prej tyre janë miratuar me vendim të bashkëkryetarëve të Këshillit Konsultativ.

LLOJET E AKTEVE	2021
Projektvendime	42
Projektligje	5
Projektudhëzime	3
Prezantime	13
Total	63
Të pamiratuara	0
Të kaluara direkt në KM	3



Zbatimi i Matricës së Kompetencave për 2021

Bazuar në listën e rekomandimeve të Matricës së Kompetencave për vitin 2021 dhe përlllogaritjen e paraqitur në tabelën e mëposhtme, shkalla e zbatimit, përkatësisht niveli i harmonizimit ligjor, është 58%.

Shkalla e përgjithshme e zbatimit llogaritet si raport i numrit të përgjithshëm të akteve ligjore të miratuara ndaj numrit total të akteve ligjore të rekomanduara pa përfshirë aktet e përcaktuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019. Rrjedhimisht, niveli i harmonizimit është zberthyer për ministritë e linjës, duke përdorur të njëjtën metodologji:

Institucioni	Numri i draft akteve të rekomanduara	Aktet e miratuara	Niveli i Harmonizimit (%)
Ministria e Brendshme	1	0	0%

¹ sipas indikatorit nr.8, "Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe kapaciteteve në pushtetin vendor".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6	6	100%
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	2	1	50%
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	4	2	50%
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	1	0	0 %
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2	1	50%
Ministria e Arsimit dhe Sportit	1	0	0%
Total	17	10	58%

1. Ministria e Brendshme ka 1 projektakt ligjor të rekomanduar, lidhur me Policinë Bashkiake, i cili është ende në proces, për rrjedhojë shkalla e zbatimit është 0%.
2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë kapasur numrin më të madh të rekomandimeve, 6 Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) dhe Udhëzime, kryesisht në fushën e strehimit dhe financave vendore. Siç raportohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, baza ligjore në lidhje me funksionet e deleguara për qeverisjen vendore, nën përgjegjësinë e kësaj Ministrie është harmonizuar 100%.
3. Ministria e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural ka një shkallë zbatimi 50%. Gjithsej janë 2 projektakte për vitin 2021 të rekomanduara për këtë Ministri, që kanë të bëjnë me bujqësinë dhe zhvillimin rural, ndërsa është miratuar një projektakt.
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka një shkallë zbatimi prej 50%, më konkretisht me 4 akte ligjore të rekomanduara për këtë Ministri dhe 2 të miratuara me VKM-të përkatëse. Një akt që nuk është miratuar, ka të bëjë me shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, i cili është në proces, për shkak të reformës thelbësore të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare në këtë sektor.
5. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka një shkallë zbatimi 0%. Gjithsej është 1 projektakt i rekomanduar për këtë Ministri në lidhje me depozitimin e mbetjeve publike, të cilat janë ende në proces miratimi.
6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka rekomandim 2 projektakte, ku një është miratuar me VKM-të përkatëse, dhe shkalla e zbatimit të këtij rekomandimi është 50%.
7. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka 1 projektakt lidhur me mbi funksionin e arsimit parashkollor. Megjithatë, siç raporton kjo Ministri, të gjitha rekomandimet janë të

integruara në bazën ligjore ekzistuese, ku aktualisht nuk ka nevojë për ndryshime shtesë për vitin 2021. Prandaj, rekomandimi specifik nuk është adresuar në vitin përkatës 2021.

Niveli i përfaqësimit të Qeverisë Qendrore

Bazuar në Vendimin nr. 910, datë 21.12.2016 “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore, kreu III “Krijimi dhe përbërja, drejtimi i këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, pika 7, ku në përbërje të këshillit janë 22 anëtarë vërehet që mesatarisht, gjatë vitit 2021 kanë qenë të pranishme në mbledhjet e Këshillit 66 % e ministrive të linjës. Nga 11 ministri që përfaqësohen në Këshillin Konsultativ, 2 prej tyre kanë qenë të pranishme në të gjitha mbledhjet, ose 18% e ministrive gjithsej; 3 ministri ka qenë e pranishme në 5 mbledhjet, ndërsa ministrinë e tjera kanë qenë të pranishme në 2 deri 3 mbledhje;

Gjatë vitit 2021, 1 ministri ka qenë e pranishme në Këshill përfaqësuar nga ministri, në 1 mbledhje, ndërsa 3 ministri janë përfaqësuar në të gjitha mbledhjet me Zv/Ministër. Me përjashtim të rasteve të mësipërme, ministrinë kanë qenë të pranishme në Këshill me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike.

Pjesëmarrja e ministrive të linjës e paraqitur me tabelë si më poshtë:

MINISTRITË	2021
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	5
Ministria e Brendshme	1
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	1
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	0
Ministria e Shtetit për Diasporën	0
Ministria e Kulturës	2
Ministria e Drejtësisë	0
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	2
Ministria e Mbrojtjes	5

Niveli i përfaqësimit të Qeverisë Vendore

Nga 11 anëtarët përfaqësues të qeverisë vendore, Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë Shoqata për Autonominë Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë kanë qenë të pranishme pothuajse në të gjitha mbledhjet e zhvilluara të Këshillit Konsultativ. Mesatarisht 7 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2021, që përbën rreth 11 % të bashkive të

vendit, megjithatë numri është luhatur ndjeshëm ndërmjet mbledhjeve, nga 5 në 30 bashki të pranishme.

Mesatarisht 6 bashki kanë qenë të përfaqësuara në mbledhjet e vitit 2021 nga kryetari, që përbën rreth 10% të bashkive të pranishme. Pjesa tjetër, kanë qenë të pranishme me përfaqësues të niveleve më të ulëta hierarkike.

Konstatime

a. Në lidhje me përfaqësimin e qeverisjes qendrore, në krahasim me kërkesat ligjore.

Përgjithësisht, niveli i përfaqësimit në Këshill gjatë vitit 2021 të qeverisë qendrore është i kënaqshëm përkundërt kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit.

Në drejtim të pranisë në mbledhje, niveli mesatar i pjesëmarrjes së ministrive arrin në 66%, ndërkohë që 18% e tyre kanë qenë të pranishme vetëm në dy mbledhje. Përgjithësisht, vërehet se ministrinë, marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit vetëm nëse agjenda e saj përfshin çështje ose projekt akte që lidhen me fushën e tyre të përgjegjësisë.

Në drejtim të nivelit hierarkik të përfaqësuesit, vërehet një niveli i ulët përfaqësimit me zv. ministrin, ndërsa pjesa më e madhe e ministrive përfaqësohen me nivele më të ulëta hierarkie në pjesën më të madhe të mbledhjeve.

b. Në lidhje me përfaqësimin e njërive të vetëqeverisjes vendore, në krahasim me kërkesat ligjore

Përgjithësisht, niveli i përfaqësimit në Këshill gjatë vitit 2021 të qeverisjes vendore është i lartë përkundërt kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit.

Sekretariati Teknik i Këshillit

Në zbatim të VKM-së 910, datë 21.12.2016 "Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore i ndryshuar", përcaktohet se roli i Sekretariatit Teknik të Këshillit Konsultativ kryhet nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Sekretariati është ura lidhëse midis qeverisë qendrore dhe atyre vendore dhe synon një rritje të rëndësishme të koordinimit midis qeverisë qendrore dhe njërive vendore, që bashkitë të ndihmohen me analiza dhe rishikime konkrete mbi të cilat të bazojnë politikat e tyre të zhvillimit. Sekretariati Teknik gjatë vitit 2021 ka kryer të gjitha detyrat që ka në këtë kuadër duke garantuar infrastrukturën dhe komunikimin e nevojshëm për zhvillimin normal të seancave plenare të këshillit konsultativ.

Aneks 1 Lista e projekt akteve ligjore të miratuara në Këshillin Konsultativ

Projekt akte të paraqitura për diskutim/të miratuara
Projektligj “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative”
Projektvendim “Për miratimin e modelit të prospektit BID” „Për përcaktimin e metodologjisë dhe kriterëve të llogaritjes së kuotës BID
Udhëzim " Për miratimin e marrëveshjes operacionale TIP”
Projektvendim “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për të konsumuar nga njeriu”
Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive
Projektvendimi “Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie”
Projektvendim “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore
Projektvendim “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”.
Projektvendim ”Për organizimin, funksionimin dhe mënyrën e përfaqësimit të organeve të qeverisjes vendore në Këshillin Konsultativ trepalësh rajonal”
Projektvendim” Për përcaktimin e detyrave dhe bashkëpunimin e njësive të qeverisjes vendore me shërbimin veterinar”
Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030”
Projektvendim “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës”
Projektvendim “Për caktimin e procedurave dhe mënyrat e administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura”
Projektvendim “Për miratimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”.
Projektvendim “Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre”
Projektvendim “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet të pronësisë midis enteve pronare të rrugëve”
Projektvendim “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve të planit të veprimit për periudhën 2021-2027”
Projektvendimin “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”
Projektligji “Për ndërmarrjet micro, të vogla e të mesme”
Projektvendim “Për miratimin e procedurave të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”
Projektvendim “Për një shtesë në VKM Nr. 687, datë 29.07.2015, Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve së bashku me relacionin shoqëruar”
Projektvendim “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”

Projektvendim “Për kriteret e hartimit të planeve të menaxhimit si dhe për përcaktimin e ekosistemeve, habitateve dhe llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje”.
Projektvendim “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve që përfitojnë statusin e nivelit të lartë dhe trajnerëve të tjerë”
Projektvendim “Agjenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026”
Projektvendim “Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021-2025”
Projektvendim "Plani kombëtar i veprimit për personat LGBTI+, 2021-2027”
Projektvendim “Treguesit statistikorë të vlerësimit të ndihmës ekonomike të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore si dhe peridiocitetin e mbledhjes së tyre”
Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10112 dt. 9.04.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë së ndërtesave të banimit"
Projektvendim “Për miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile"
Projektvendim “Për përcaktimin e kategorive të ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi i pikës së aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike”
Projektvendim “Mbi miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë”
Projektvendim “Mbi përcaktimin e rregullave për infrastrukturën e brendshme për rrjetet e komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe administrimin e pikës së aksesit në godina”
Projektvendim “Për miratimin e kriterëve për identifikimin e subjekteve private strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre"
Projektvendim “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të krijimit të sistemit të gjurmimit të artikujve piroteknike”
Projektvendim “Buxheti për pushtetin vendor 2022”
Projektligji “Për Policinë Bashkiake”
Projektvendim “Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive”
Projektvendim “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”
Projektvendim “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë”
Projektvendim “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar"
Projektvendim “Për strukturën e regjistrimit kombëtar të fondit pyjor, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mbajtja e të dhënave, informacioni që regjistrohet dhe raportimi nga administratorët/pronarët e pyjeve”
Projektvendim “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për tu konsumuar nga njeriu”(ridërguar)
Projektvendim “Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës së vendit”
Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Projektvendim "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme, "Ndërtesa"
Udhëzim "Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e çmimit mesatar të shitjes së banesave në treg"
Projekt akte të pa diskutuara
Projektvendim "Për përcaktimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe miratimin e aktit individual të kalimit të pronësisë"
Projektvendim "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të proceseve kalimtare të pronësisë"
Projektvendim "Për procedurat e regjistrimit, rregullimit të sipërfaqes grafike për aktet e marrjes së tokës në pronësi, të miratuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë si dhe për përcaktimin e normës së sipërfaqes shtesë dhe pronës shërbyese"
Projektvendim "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale"
Projektvendim "Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë në zbatim të ligjit nr. 169/2020, "Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore"
Projektligji "Për rezervat materiale të shtetit"
Projektvendim "Për mbështetjen financiare për menaxhimin e mbetjeve në bashkitë e qarkut Durrës"
Projektvendim "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 173 datë " Për miratimin e rregullores" Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" të ndryshuar
Projekt akte të pa miratuara
s'ka
Prezantime/Raporte
Dokument Politikash 1. Përfshirja e Pushtetit Lokal në portalin "Mësues për Shqipërinë" për mësueset e Arsimit Parashkollor si një funksion i decentralizuar 2. Diskutimi mbi shërbimin psiko-social në arsimin parashkollor 3. Gjetjet dhe rekomandimet në Raportin e Sintezës "Për Mbrojtjen Civile në Nivel Vendor",
Raporti vjetor për financat publike vendore 2020
Prezantim "Karta Evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore dhe zbatimin në Shqipëri nga bashkitë nënshkruese"
Prezantim "Raporti I përputhshmërisë të vitit 2020"
Prezantim "Raporti studimor mbi performancën e bashkive në zbatim të buxhetit për vitin 2020"
Prezantim "Vlerësimi I Metodologjisë së Kapitalit Natyror të Bashkisë"
Raportin e monitorimit të dokumentit të politikave strategjike dhe planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035;
Dokument politikash "Mbi ndryshimet ligjore dhe financiare të përgatitura nga ekspertë të fushës dhe nga takimet rajonale dhe qendrore për mundësinë e rritjes së nivelit të rentës në favor të bashkive;
Prezantim "Sfidat e Bashkive të Vogla në Raport me Agjendën Decentralizuese"

Aneks 2 Matrica e Kompetencave per vitin 2021

Ministria e Brendshme			
Nr	Rekomandime	Akti (nr. date)	Informacione të tjera
1	Rekomandim [93]: Rekomandohet të shfuqizohet neni 12 i ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”	Në proces miratimi	
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë			
Nr	Rekomandime	Akti (nr. date)	Informacione të tjera
2	Rekomandim [3]: Rekomandohet rishikimi, përditësimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.	Në proces miratimi	Nga ana e MIE /Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e e U-K është me mbështjen e GIZ përgatitur Draft Strategjia Kombëtare sektoriale 2020-2030. Statusi aktual: Pasi ka përfunduar hartimi i paketës së plotë ligjore për miratimin e strategjisë, mbetemi në pritje të vendim-marrjes politike për ecurinë e mëtejshme në kuader të reformimit të thellë të sektorit të ujesjelles –kanalizimeve, të ndërmarre nga Qeveria Shqiptare
3	Rekomandim [7]: Rekomandohet shfuqizimi i VKM-së nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin UK".	Në proces miratimi	
4	Rekomandim [19]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për tu përshtatur me kërkesat e ligjit nr. 124/2015.	VKM nr. 285, datë 19.05.2021	https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/19/285/3c57e062-6a88-4b44-81ce-593b7af2b0c1
5	Rekomandim [21]: Rekomandohet përfshirja në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë objektivi lidhur me ndriçimin e mjediseve publike, si një sektor që kryesisht përfshihet si konsumator i madh	Ligji Nr. 28/2021	https://qbz.gov.al/eli/ligji/2021/03/08/28/2d9699d1-9401-49af-b70e-a251617d2574

	energije elektrike.		
--	---------------------	--	--

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nr	Rekomandi me	Akti (nr. date)	Informacione të tjera
6	<p>Rekomandim [61]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për përcaktimin e kriterëve për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, me qëllim strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre.</p>	<p>VKM Nr. 142, dt. 10.03.2021</p>	<p>https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/03/10/142/3e34169d-3b85-4c3e-8495-3126064f4d4a</p>
7	<p>Rekomandim [62]: Rekomandohet miratimi i VKM-së për miratimin e procedurave të përzgjedhjes, mënyra e kontraktimit, forma dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin, të cilat do të realizohen sipas marrëveshjes për ndërtimin e banesave, që kryhet nga subjekte private, nëpërmjet partneritetit publik-privat.</p>	<p>VKM Nr. 441, dt. 22.07.2021</p>	<p>https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/07/22/441/75dd83b3-b622-453f-8c72-f74b152becfb</p>
8	<p>Rekomandim [96]: Rekomandohet të hartohen raportet sipas neneve 26 dhe 27 të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".</p>	<p>Akti: Ligji nr. 68/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore".Raporti i publikuar ne web e MFE-se (http://www.financa.gov.al/buxhet-i-i-pushtetit-vendor/). Për vitin 2021 rekomandimi permbushet me linkun https://www.financa.gov.al/viti-2021-2/ Në raportin e analizës financiare qe behet cdo vit dhe në raportin e përputhshmërsië qe po ashtu behet cdo vit perfshihen kerkesat e raportimeve sipas neneve 26 dhe 27 te ligjit 68/2017 Keto raporte publikohen ne web-in e Ministrise se Financave dhe Ekonomise.</p>	<p><u>Për vitin 2021 rekomandimi permbushet me linkun https://www.financa.gov.al/viti-2021-2</u></p>

9	<p>Rekomandim [98]: Rekomandohet që politikat fiskale dhe transferimi i përgjegjësive të reja të cilat kanë efekte financiare të drejtpërdrejta në vetëqeverisjen vendore të shoqërohen me faturë të detajuar financiare dhe proces transparent të llogaritjes së kësaj fature.</p>	<p>Për çdo akt të dalë është bere kontroll nga Ministria e Financave dhe Ekonomise dhe Ministria e Brendshme per faturën financiare. Kjo procedure tashme e konsoliduar ka bere qe te gjitha transferimet e funksioneve apo kompetencave te jene te shoqeruar me faturen perkatese financiare</p>	<p>Për vitin 2021 rekomandimi permbushet me linkun https://www.financa.gov.al/viti-2021-2</p>
10	<p>Rekomandim [100]: Në kuadër të ligjit 139/2015, neni 34, pika 5, rekomandohet hartimi i një plani financiar nga MFE për kompensimin e uljes së të ardhurave të vetëqeverisjes vendore si pasojë e ndryshimit të politikës fiskale në vite.</p>	<p>Eshte bërë rast pas rasti (psh ulja e te ardhurave nga taksa mbi biznesin e vogel eshte kompensuar etj.) LIGJ Nr. 137/2020 PËR BUXHETIN E VITIT 2021 AKT NORMATIV Nr. 34, datë 3.12.2021 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020, "PËR BUXHETIN E VITIT 2021", TË NDRYSHUAR</p>	<p>https://qbz.gov.al/eli/ligji/2020/11/16/137/137abe3d-84d3-407f-a07f-065ccd46af36 https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2021/12/03/34/73fed29a-0f12-43df-9683-76e99847fa0a</p>
11	<p>Rekomandim [101]: Rekomandohet që, pas një periudhe 2-3 vjeçare të zbatimit të ligjit të financave të vetëqeverisjes vendore, të kryhet një analizë e plotë e menaxhimit financiar publik në nivel vendor dhe të rishikohen planet e mundshme për shtesa ose ndryshime të dispozitave ligjore e nënligjore.</p>	<p>Raportet e analizes per buxhetin vendor te publikuara ne web-in e MFE-së (http://www.financa.gov.al/buxhet-i-i-pushtetit-vendor/). Per vitin 2021 rekomandimi permbushet me linkun https://www.financa.gov.al/viti-2021-2/ Analiza është bërë cdo vit dhe do të vijohet të bëhët</p>	<p>Per vitin 2021 rekomandimi permbushet me linkun https://www.financa.gov.al/viti-2021-2</p>

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Nr	Rekomandime	Akti (nr. date)	Informacione të tjera
12	Rekomandim [38]: Rekomandohet ndryshimi i VKM nr. 662 duke mënjanuar kompetencat e përbashkëta midis institucioneve qendrore dhe vendore dhe duke përcaktuar vetëm një autoritet përgjegjës për propozimin e hapjes së institucioneve të reja arsimore parauniversitare publike.		

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr	Rekomandimi	Akti Nr. Datë	Informacione të tjera
13	Rekomandim [82]: Rekomandohet të kryhen ndryshime në ligjin sektorial nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", duke (i) përcaktuar kompetencat e NJQV-ve dhe (ii) bashkërendimin e aktivitete midis MBZHR dhe NJQV-ve.	Vkm nr. 475, datë 30.7.2021	https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/07/30/475/60807b07-f7b7-49cc-b344-6d71b03a3f91
14	Rekomandim [83]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 6 i ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, të përfshihen NJQV-të në administrimin e programeve për bujqësinë e zhvillimin rural.		

Ministria e Turizimit dhe Mjedisit

Nr	Rekomandimi	Akti Nr. Datë	Informacione të tjera
15	Rekomandim [36]: Rekomandohet shfuqizimi i ligjit nr. 8094, datë 21.3.1996 "Për largimin publik të mbeturinave", përcaktimi i pronësisë së mbetjeve për NJQV-të, caktimi i tarifës së këtij shërbimi nga NJQV-të si dhe dispozita të tjera të nevojshme të këtij ligji të shtohen në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar.		

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Nr	Rekomandime	Akti (nr. date)	Informacione të tjera
16	<p>Rekomandim [47]: Duke qenë se shumë shërbime të NJQV-ve kanë nevojë të mbështeten me instrumente dhe fonde për mbrojtjen e shëndetit publik, të tilla si, sigurimi dhe kontrolli i cilësisë së ujit të pijshëm, monitorimi i kanalizimeve, monitorimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake si dhe shërbimet e NJQV-ve në fushën emjedisit dhe mbrojtjes së tokës dhe biodiversitetit, rekomandohet zhvillimi i një strategjie për implementimin e krijimin të këtyre qendrave me pjesëmarrje e NJQV.</p>		
17	<p>Rekomandim [51]: Rekomandohet ndryshimi i nenit 41 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Shërbimeve Shoqërore të ushtrisë të drejtën për të vendosur masa administrative drejtpërdrejtë, duke mbyllur ciklin e monitorim dhe vlerësimit në nivel qendror.</p>	<p style="text-align: center;">VKM nr. 276, datë 12.5.2021</p>	<p>https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/12/276/0426afc6-f905-4823-b2dd-1947a8fab811</p>

Shtojca



Raport Vleresimi PI
- clean.pdf